



15.05.2020

Letër për prindërit mbi projektet ndihmëse

Informacione mbi kushtet e hapjes së projekteve ndihmëse

Duke filluar nga 14.05.2020 projektet ndihmëse mund të hapen përsëri. Projektet ndihmëse janë mundësi të vogla përkujdesje, të cilat duhet ti lehtësojnë fëmijëve dhe prindërve të tyre rrugën për te kujdesi institucional ditor kundrejt fëmijëve. Grupi i synuar janë fëmijët e grupit të moshave parashkollore që vijnë nga familje të emigrantëve dhe persona të tjerë në të njëjtën situatë jetese si dhe familjet e tyre (emigrantë nga vende të ndryshme, edhe nga vende jashtë BE-së, kërkues/e azili etj.).

Por duke pasur parasysh situatën aktuale në kuadrin e pandemisë Corona këto projekte mund të zhvillohen vetëm duke në kushte të veçanta.

Ofruesit e projektit vendosin me përgjegjësinë e tyre nëse ato mund ti hapin përsëri ato duke filluar nga data 14.05.2020 duke i kushtuar vëmendje kushteve të reja. E drejta për hapjen e mundësive dhe kryerjen e tyre në kuadrin e zhvilluar deri më tani nuk ekziston. Prandaj ne ju lutemi që të kemi mirëkuptimin tuaj. Kushtet e listuara më poshtë vlejné për të kufizuar më tej përhapjen e infeksionet dhe sidomos për të mbrojtur të punësuarit, por edhe fëmijët dhe prindërit kundrejt mundësisë së infektimit.

1. Fëmijët dhe prindërit, të cilët dëshirojnë të shfrytëzojnë projektet ndihmëse,

1.1 nuk lejohet të shfaqin simptoma të sëmundjes,

- 1.2 nuk lejohen që me dijeninë e tyre të qëndrojnë në kontakt me persona të infektuar, përveç rastit kur nga kontakti me personin e infektuar kanë kaluar 14 ditë dhe ato nuk kanë shfaqur asnjë simptomë,
- 1.3 duhet që pas mbërritjes së tyre në Republikën Federale të marrin masat mbrojtëse bazuar në rregulloren në fuqi në periudhën kohore përkatëse të landit Nordrhein-Westfalen.

2. Numri maksimal i fëmijëve dhe i prindërve në projektet ndihmëse

Lejohet që maksimumi dhjetë fëmijë - në varësi të llojit dhe me pjesëmarrjen e një prindi - të marrin pjesë në një projekt ndihmës.

Nëse mund grupet e deritanishme më të mëdha mund të ndahen ose ndoshta jo të gjithë fëmijët dhe prindërit mund të marrin pjesë në një takim, vendoset nga zhvilluesi në vend me përgjegjësinë e tij individuale. Nëse në një rast të tillë do të aplikohen kufizime në krahasim me mundësitë e ofruara deri më tani, ne apelojmë për mirëkuptimin dhe gatishmërinë tuaj për të bashkëpunuar.

3. Ndjekja e kontakteve

Para pjesëmarrjes në projektin ndihmës ju duhet të deklaroni të gjitha të dhënat e kontaktit të gjithë personave të përfshirë në familjen tuaj, në mënyrë që të mund të ndiqen zinxhirët e mundshëm të infektimit. Zhvilluesit e projektit ose personat e kujdesit ditor të fëmijëve do ja vendosin në dispozicion këto të dhëna më pas në rast nevojë menjëherë autoriteteve shëndetësore.

4. Urdhri për respektimin e distancës

Gjatë kryerjes së një projekti ndihmës vlen gjithmonë urdhri për respektimin e distancës minimale prej 1,5 merash për të gjithë të rriturit. Vendimi për mbajtjen e një maske mbrojtëse që mbulon gojën dhe hundën në gjatë zhvillimit të projektit ndihmës mbetet në përgjegjësinë e zhvilluesve ose të personave të kujdesit ditor. Kjo gjë vlen si për personelin e përdorur ashtu edhe për prindërit.

5. Udhëzime mbi higjienën për fëmijët dhe prindërit

Viruset Corona transmetohen kryesisht nëpërmjet spërklave. Prandaj është e rëndësishme që të minimizojmë sa të jetë e mundur rreziqet për shkaktimin e një infektimi. Një element i rëndësishëm në këtë rast është respektimi i masave higjienike të projektet ndihmëse.

Prandaj është e rëndësishme që vetë prindërit ti respektojnë rregullat e higjienës, di dhe ti ushtrojnë ato edhe me fëmijët në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tyre dhe ti përdorin ato edhe në projektin ndihmës.

Në këtë rast i duhet kushtuar vëmendje sidomos rregullave të mëposhtme të sjelljes:

- Lani shpesh dhe mirë duart. Përdorni gjithmonë sapun.
- Nëse duhet të kolliteni ose të teshtini, atëherë kollituni ose teshtini në këndin e bërrylit.
- Përdorni shami letre. Hidhini menjëherë shamitë e përdorura të letrës direkt në një kosh të mbyllur plehrash.

Këshilla dhe informacione të tjera gjeni në faqet e mëposhtme:

<https://www.mags.nrw/coronavirus>

<https://www.infektionsschutz.de/hygienetipps>

<https://www.waschen-wie-walter.de>

**Ministria për fëmijët, familjet, emigrantët dhe integrimin
e landit të Nordrhein-Westfalen**